

# E drejta e informimit 2018 – Informacioni i vonuar është informacion i mohuar



**CIVIL  
RIGHTS  
DEFENDERS**



**SWEDEN**

Informacioni  
i vonuar  
është  
informacion  
i mohuar

Më 28 Janar 2019, Res Publica prezantoi raportin për të drejtën e informimit gjatë vitit 2018. Raporti është pjesë e një projekti të mbështetur nga Civil Rights Defenders, me fonde të Mbreterisë së Suedisë, i cili konsiston në mundësimin e qytetarëve të aksesojnë informacionet publike, si dhe në berjen e një vlerësimi të punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

Një kermill (simboli i ngadalesisë) tërheq një dosje avash avash për ta sjellë të kerkuesi. Dosja megjithatë një ditë mberrin, ajo quhet se nuk ka ardhur kurre (për atë kohë sa

ishte i vlefshem si informacion). Nën këtë metaforë, raporti solli shifra krahasuese me periudhat e mëparshme (vitet 2015, 2016, 2017), për të vënë re nëse ka përmirësime apo përkeqësime të treguesve. Në thelb të diskutimit u shtrua përkisht vonesa në marrjen e informacionit, e cila dukshëm është shtuar gjatë vitit 2018. Afati i kthimit të përgjigjeve fillestare është rritur nga 13 në 26 ditë. Afati i reagimit pas ankimit administrativ është rritur nga 13 në 25 ditë. Vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit merren për mesatarisht 54 ditë. Nderkohe që cilësia e vendimeve të Komisionerit është e mirë, dinamika e trajtimit të rasteve ka lënë për të dëshiruar, duke sjellë si pasoje një relaksim të institucioneve kundër detyrimeve sipas ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Këtu, por edhe gjetje të tjera që flasin për problematika të vecanta, janë bërë pjesë e studimit të plotë, të cilin mund ta shkarkoni këtu.